

PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN
FINANCIAR TË KOSOVËS



FORUM I HAPUR: SEKTORI BANKAR DHE SISTEMI I ZBATIMIT TË KONTRATAVE NË KOSOVË

PERIODIKU BANKAR



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 Banka Ekonomike



 BPB

 iSBANK

 NLB Banka

 ProCredit Bank

 Raiffeisen
BANK

 TEB
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

 ZiraatBank

PËRGATITUR NGA:

DR. SC. PETRIT BALIJA,
Kryeredaktor

KRESHNIK KOSUMI,
Redaktor

MIRANDA RUGOVAJ
Koordinatore

MITHAT SEJDIU
Dizajn

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,
Gusht 2016



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Deklarata e autorësisë: Materiali në këtë publikim ka të drejta autoriale. Kopjimi apo përdorimi i një pjese apo i tërë publikimit pa leje apo pa shënuar burimin e informacionit mund të konsiderohet shkelje e ligjeve në fuqi.

FORUM I HAPUR: SEKTORI BANKAR DHE SISTEMI I ZBATIMIT TË KONTRATAVE NË KOSOVË

PËRMBAJTJA

PJESA I

Sistemi i përmbartimit në Kosovë dhe ndikimi në kreditë jo-performuese 1-4

PJESA II

Indikatorët kryesorë të industrisë bankare të paraqitura në numra dhe figura 5

Struktura e aseteve 5-6

Struktura e detyrimeve 6-8

Të hyrat dhe shpenzimet 8-11

Norma efektive e interesit në kredi dhe depozita 11-12

Kreditë jo-performuese 12-13

PJESA III

Lajme nga industria bankare dhe ekonomia 14- 17

Deklarimi i përgjegjësive: Mendimet dhe opinionet e paraqitura në këtë publikim janë përmbledhje e diskutimeve nga panelet e forumit. Këto mendime dhe opinione nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Shoqatës së Bankave të Kosovës. Kjo përmbledhje do të shërbej për reflektim mbi atë se çfarë është konkluduar nga diskutimet një ditore të Forumit, në mënyrë që institucionet relevante të mund të ndërmarrin masat respektive për të përmirësuar mjedisin afarist në Kosovë.

I. FORUM I HAPUR: SEKTORI BANKAR DHE SISTEMI I ZBATIMIT TË KONTRATAVE NË KOSOVË

Shoqata e Bankave të Kosovës ka organizuar forumin e hapur, me ç'rast është diskutuar lidhur me rolin e sektorit bankar në zhvillimin ekonomik të vendit, sfidat me të cilat ballafaqohet ky sektor lidhur me mbledhjen e borxheve nga kreditë joperformuese, sistemin e tanishëm të përmbarimit të kontratave, si dhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit në mes të sektorit bankar, si kredihënësi më i madh në vend, dhe institucioneve relevante, të cilat janë përgjegjëse për përmbarimin e kontratave në Republikën e Kosovës.

Një nga qëllimet e organizimit të këtij forumi ka qenë edhe shkëmbimi i ideve lidhur me avansimin e mëtejshëm të sistemit të përmbarimit të kontratave, në mënyrë që të krijohet një sistem edhe më efektiv i përmbarimit, lidhur me mbledhjen e borxheve nga kreditë joperformuese.

14 Qershor 2016 – Hotel Swiss Diamond



Pjesëmarrësit: Gjithsej 45 pjesëmarrës nga Ministria e Drejtësisë, Gjykatat, Përmbaruesit Privat, Banka Qendrore e Kosovës, Fondi Monetar Ndërkombëtar, USAID CLE, Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive dhe industria bankare.



Angazhimi i përmbaruesve privat në përmbarimin e rasteve gjyqësore të bankave ka ndihmuar shumë në zvogëlimin e numrit të kredive jo-performuese. Në forum gjithashtu u vlerësua se shumë sfida ende mbesin për t'u adresuar dhe se ky forum paraqet një platformë shumë të mirë për t'i diskutuar me akterët relevant të këtij sistemi.



Drejtor Ekzekutiv i SHBK-së, Petrit Balija, theksoj rolin e rëndësishëm që e bartin përmbaruesit privat për industrinë bankare, me ç'rast përmendi disa nga sfidat të cilat ende kanë mbetur në kuadër të këtij sistemi. Disa nga sfidat që u përmendën ishin: numri i madh i lëndëve të pazgjidhura, zbatimi i pjesërishëm i vendimeve, mangësitë e sistemit ligjor të cilat rregullojnë sistemin e zbatimit, vonesat në sistemin gjyqësor në lidhje me aspektet teknike dhe administrative, procesi i tejzgjatur në apelimin e rasteve gjyqësore në rastet e ankesave, numri i vogël i gjykatësve etj.



Fehmi Mehmeti, Zëvendës Guvernator në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) theksoj se në kuptim të kushteve rregulluese si dhe nga institucioni më proaktivë i mbikëqyrjes bankare, vlerësohet se kualiteti i kredive të lëshuara është shumë më i mirë. Kjo performancë është si rezultat i përdorimit të modeleve të reja biznesore nga ana e bankave, kushteve të zbatimit të kontratave dhe si rezultat i vënies në funksion të përmbaruesve privat, të cilat paraqesin disa nga faktorët kryesorë që kanë kontribuar në zvogëlimin e kredive jo-performuese.



Robert Wright, Drejtor Ekzekutiv në Raiffeisen Bank në Kosovë, theksoj se korporatat në Kosovë i kanë afërsisht 200 milion euro borxh institucioneve bankare. Kosova në listën e të bërit biznes të bankës botërore është e renditur në vendin e 26-të sa i përket qasjes në kredit, përderisa në zbatimin e kontratës, Kosova renditet në vendin e 140-të. Kjo tregon se ka ende hapësirë të mjaftueshme për të përmirësuar sistemin e përmbarimit, në mënyrë që t'i ndihmohet biznesit vendor.

Zëvendës Guvernatori e vlerësoj si shumë pozitive faktin se numri dhe vlera e kredive është rritur, përderisa kostoja e financimit është zvogëluar. Ndërmjet shumë faktorëve në rritjen e kredive, padyshim është edhe fakti i zvogëlimin të koston së financimit. Ne duhet ta theksojmë si një arritje dhe

progres shumë të rëndësishëm faktin e zvogëlimin të normave të interesit në kredi. Vetëm para dy viteve këto norma ishin dy-shifrore, përderisa tani këto janë në nivel një-shifror dhe është duke konkuruar me vendet e rajonit.

Përfaqësuesi i Fondit Monetar Ndërkombëtar, Ruud Vermeulen, theksoj se ky forum është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të përforcimit të sistemit, në dobi të sektorit bankar si dhe të ekonomisë në përgjithësi. Ai diskutoj mbi përvojën e disa vendeve të rajonit sikurse edhe të vendeve të BE-së në lidhje me sistemin e përbarimit, me qëllim që të identifikoj zgjidhjet potenciale mbi sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova. Z. Vermeulen gjithashtu dha një vlerësim pozitiv mbi zhvillimet aktuale në sektorin bankar të Kosovës, duke theksuar se ky sektor në Kosovë është një nga më të mirët në performancën e tyre në krahasim me vendet në rajon. Ne jemi shumë të interesuar në zbatimin e kontratave, meqenëse kjo do të ndihmon shumë në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe ky fakt gjithashtu do të ndikoj në zhvillimin e vendit. Kreditë jo-performuese i zvogëlojnë financimet dhe investimet

Përfaqësuesi i Odës së Përbaruesve Privat, Gjokë Radi, theksoj se përbaruesit janë pjesë të sistemit gjyqësor në Kosovë, mirëpo në kuadër të biznesit privat si organ përbarimor. Ai vlerësoj se pavarësisht që përbaruesit privat e kanë përmirësuar gjendjen e zbatimit të kontratës, megjithatë ata ballafaqohen me sfida të shumta. Qasja në dokumentet zyrtare, sikurse që është rasti tek Agjencia Kadastrale e Kosovës, e cila me ligj është e detyruar të ofroj të dhëna pa pagesë, paraqet një nga këto sfida. Sfidë tjetër është se jo çdoherë propozimet e rasteve janë mirë të specifikuar.

Feride Podvorica, përfaqësuese nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Drejtësisë, vlerësoj se sistemi i përbarimit në Kosovë është një sistem i ri të cilët i përbarojnë lëndët në bazë të dokumenteve të cilat prezantohen. Përmes Ligjit të Procedurës Përbarimore (LPP), përbaruesve privat i janë besuar përgjegjësi publike dhe emërohen për territore të gjykatave themelore. Nga praktika dhe përvoja e deritanishme janë identifikuar disa vështirësi dhe paqartësi në zbatimin e LPP-së dhe si rezultat i kësaj tani jemi në proces të amendamentimit të këtij ligji. Disa nga çështjet të cilat janë adresu në proces të



kontratave parandalon zhvillimin e mëtutjeshëm të bizneseve. Mungesa e të dhënave si dhe ekzistenca e dy-kuptimësive tek dispozitat ligjore mundësojnë shmangjen e pagesave, përderisa mungesa e mekanizmave për përbaruesit privat janë disa nga zbrazëtitrat të cilat e pengojnë zhvillimin e mëtutjeshëm.



amandamentimit janë regjistri i llogarive bankare në BQK, prapësimi – vendosja e afatit, numri i ankandeve publike, mekanizmi i mbikëqyrjes së përbaruesve privat, tarifa e efikasitetit etj.

Përfaqësuesi i Programit të USAID për zbatimin e kontratave ligjore, Ardi Shita, theksoj se megjithëse rezultati i punës së përmbauesve privat është evident, përmbauesit privat paraqesin vetëm një nga sistemet që ndihmojnë në uljen e rrezikut. Rëndësi të veçantë ka edhe vënia në jetë e ligjit të falimentimit të cilën programi i tyre është duke e përkrahur. Deri tani kemi tri raste të falimentimit, mirëpo asnjë rast të falimentimit të përfunduar. Problem tjetër është se në Kosovë, aktualisht mbi 85% e bizneseve që janë të regjistruara, janë biznese individuale, andaj

ky ligj pritet të përmirësoj dukshëm këtë situatë duke e ndihmuar sektorin privat. Ligji për kamatvonesën i cili pritet të aprovohet e definon qartë të drejtën, përcakton dhe autorizon BQK-në për të nxjerrë rregullore për të mbikëqyrë institucionet financiare. Gjithashtu përkrahja e gjykatësve me zyrtarë ligjor përmes Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, do të shumëfishoj performancën e gjykatave në ekzekutimin e lëndëve gjyqësore për rastet ekonomike dhe kjo do të paraqiste zgjidhje më të përhershme.



II. INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRIËS BANKARE

Struktura e asetëve

STRUKTURA E ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010-2016)
(milion euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Maj-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.2	434.1
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.7	316.0	323.4
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.5	436.2
Kreditë dhe lizingu	1458.7	1698.1	1763.4	1805.8	1882.4	2019.4	2143.2
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.3	56.4
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	27.9	29.8	29.1
Gjithsej Asete	2455.1	2649.7	2829.3	3059.3	3185.6	3387.3	3422.4

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

PËRBËRJA E STRUKTURËS SË ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010 -2016)
(milion euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Maj-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.5%	12.5%	15.0%	15.1%	14.0%	14.5%	12.7%
Bilanci me bankat komerciale	17.9%	12.4%	10.2%	11.1%	12.3%	9.3%	9.4%
Letrat me vlerë	7.1%	7.6%	9.1%	11.6%	12.0%	14.0%	12.7%
Kreditë dhe lizingu	59.4%	64.1%	62.3%	59.0%	59.1%	59.6%	62.6%
Asetet fikse	1.8%	1.8%	2.0%	1.8%	1.7%	1.7%	1.6%
Asetet tjera	1.3%	1.6%	1.3%	1.3%	0.9%	0.9%	0.8%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010 - 2016)											
(milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4
Maj-16	54.6	28	166.8	20.7	101.2	725.8	47.2	21.6	96.9	129	1,391.80

Tab. 3 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

PJESËMARRJA E KREDIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010-2016)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	3.7%	1.4%	12.5%	1.8%	10.7%	51.0%	3.9%	1.9%	2.2%	11.1%	100.0%
2011	3.5%	1.5%	11.9%	1.3%	10.1%	52.7%	3.5%	2.0%	4.8%	8.7%	100.0%
2012	3.7%	1.4%	11.1%	1.3%	10.5%	53.2%	3.2%	1.9%	4.6%	9.1%	100.0%
2013	3.8%	1.7%	10.8%	1.7%	9.8%	52.6%	4.0%	1.6%	5.6%	8.4%	100.0%
2014	4.0%	1.6%	12.2%	1.6%	8.5%	53.7%	4.1%	1.4%	4.8%	8.1%	100.0%
2015	4.5%	1.4%	12.3%	1.3%	7.5%	51.2%	3.8%	1.6%	7.1%	9.3%	100.0%
Maj - 16	3.9%	2.0%	12.0%	1.5%	7.3%	52.2%	3.4%	1.5%	7.0%	9.3%	100.0%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIJË BANKARE (2010-2016)							
(milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Maj-16
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.6	43.4	81.1
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,702.9	2,674.9
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6	19.7
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	2.7	3.8
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.2	189.1	189.8
Borxhi i ndërruar	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3	36.9	38.0
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.0	392.7	415.2
Gjithsej Detyrime	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,185.6	3,385.3	3,422.5

Tab. 5 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIISË BANKARE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Maj-16
Bilanci nga bankat tjera	2.9%	1.5%	0.2%	0.5%	1.0%	1.3%	2.4%
Depozitat	78.9%	79.4%	80.6%	80.1%	79.7%	79.8%	78.2%
Huatë tjera	1.0%	1.1%	0.7%	0.4%	0.4%	0.5%	0.6%
Provizionet e shlyera	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
Detyrimet tjera	6.5%	7.2%	7.8%	8.0%	7.2%	5.6%	5.5%
Borxhi i ndërvarur	1.4%	1.2%	1.1%	1.8%	1.5%	1.1%	1.1%
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.0%	0.0%	-	-	-
Mjetet vetanake	9.4%	9.5%	9.6%	9.1%	10.1%	11.6%	12.1%
Gjithsej Detyrime	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab. 6 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese




Fig. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

Të hyrat dhe shpenzimet

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (2010-2016) (milion euro)								
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	169.6	2.7	3.1	0.4	37.5	3.9	0.0	217.2
2011	186.3	4.1	4.2	0.5	41.7	3.3	0.0	240.1
2012	194.9	2.0	3.0	0.6	44.2	2.4	0.0	247.0
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	190.7	1.1	2.9	2.5	44.6	3.1	0.5	245.3
2015	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 7 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 3 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE
(milion euro)

Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
2010	49.4	4.8	1.1	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.5	184.8
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	36.4	3.3	4.5	11.1	20.5	42.7	35.1	24.4	6.8	184.8
2015	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 8 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 4 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)								
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
Mar-15	45.8	0.2	1.0	0.3	11.0	1.0	0.5	59.7
Mar-16	42.8	0.1	1.0	-0.1	11.5	1.2	1.0	57.6

Tab. 9 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)										
Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
Mar-15	4.9	0.9	0.7	2.6	4.2	10.5	8.1	5.8	2.0	39.7
Mar-16	3.4	0.9	0.5	4.5	4.3	10.4	8.4	6.6	1.9	40.8

Tab. 10 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

Normat efektive të interesit në kredi

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI (2010-2016)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Normat efektive në kredi të reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.66%
Normat efektive për korp. jofinanc.	14.11%	13.04%	12.34%	10.75%	9.56%	7.39%	7.27%
Normat efektive për ek.familjare	13.77%	13.85%	12.00%	11.33%	8.88%	8.39%	7.95%

Tab. 11 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar




Fig. 7 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

Normat efektive të interesit në depozita

DIFERENCA NDËRMJET NORMAVE TË INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA (2010-2016)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Maj-16
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.58%
Normat efektive për gjithsej depozitat e reja	3.38%	3.62%	3.72%	2.40%	1.11%	1.15%	0.80%
Diferenca	10.59%	9.68%	8.52%	8.50%	8.18%	6.54%	6.78%

Tab. 12 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar




Fig. 8 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

Kreditë jo-performuese

KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Maj-16
Vlera e kredive jo-performuese	86.1	96.8	132.3	157.1	154.4	125.2	120.0
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%	117.7%

Tab. 13 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Maj-16
Kreditë jo-performuese (%)	5.90%	5.80%	7.50%	8.70%	8.30%	6.20%	5.60%
NPL rritja/zvogëlimi (%)	51.70%	12.50%	36.60%	18.80%	-1.70%	-18.90%	-4.10%
Përqindja e rritjes kreditore	13.20%	16.40%	3.80%	2.40%	4.20%	7.30%	6.10%

Tab. 14 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore




Fig. 9 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

Referencat

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, korrik 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, qershor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, korrik 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, korrik 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, korrik 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

PJESA III

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE DHE EKONOMIA QË SHËNUAN MUAJIN KORRIK

BQK IMPLEMENTON SISTEMIN E RI NDËRBANKAR TË PAGESAVE



Nga 1 korriku i këtij viti, sistemi ekzistues i pagesave në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) është zëvendësuar me sistemin e transferit automatik të projektuar sipas standardeve të fundit të fushës së sistemit të pagesave. Sistemi i ri ndërbankar i pagesave, i quajtur, ATS (Automatic Transfer System/Sistemi i Transferit Automatik) përbëhet nga dy komponentë kryesor: komponenti i RTGS-së (Real Time Gross Settlement/shlyerjet bruto në kohë reale), i cili mundëson transferimin e fondeve në kohë reale, si dhe komponenti ACH (Automatic Clearing House/sistem automatik i kliringut) që bënë procesimin e pagesave në grup dhe me vlerë të vogël, në tri sesione të kliringut ndërbankar në BQK. (Ekonomia Online, 6 korrik 2016).

FITIMI I BANKAVE ARRIN NË 30.5 MILIONË EURO



Të gjitha bankat komerciale në vend nga fillimi i këtij viti e deri në fund të muajit maj kanë arritur të sigurojnë një fitim të pastër prej 30.5 milionë eurosh. Nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar shihet se fitimi është më i vogël për

rreth 9 milionë euro. Bankat komerciale në vend edhe më tutje vazhdojnë të kenë afarizem të suksesshem, derisa bizneset tjera më të mëdha po përballen me vështirësi të shumta. Duke u bazuar në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), shihet se të gjitha bankat komerciale në vend nga fillimi i këtij viti e deri në fund të muajit maj kanë arritur të sigurojnë një fitim të pastër prej 30.5 milionë eurosh. Në anën tjetër Ibrahim Rexhepi, njohës i rrethanave ekonomike në vend, thotë se fitimet e bankave po ndodhin në kohën kur ka rënie të normave të interesit në kredi. “Kjo do të thotë se është rritur vëllimi i kredive dhe i investimeve të tjera që bëjnë bankat të kanë një kthim të sigurtë”, ka thënë ai. (Zëri, 1 korrik 2016).

BIE NORMA E ANKANDIT TË BONOVE TË THESARIT, SHKAK BREXIT



Qeveria e Kosovës ka mbajtur Ankandin KV011-16 të emetimit të Letrave me Vlerë, ku u ofertuan Obligacione Qeveritare dy vjeçare në vlerë nominale prej 30 milionë euro. Nga to, 12 milionë euro do të shërbejnë për ri-financimin e Obligacionit të emetuar në qershor 2014, kurse pjesa tjetër prej 18 milionë euro do të jetë e hyrë buxhetore, thuhet në një njoftim të qeverisë. Në këtë ankand tregu ka shfaqur kërkesë për blerje në vlerë 51.86 milionë euro, kurse është pranuar vetëm shuma e shpallur paraprakisht e që është 30 milionë euro. Norma e interesit për këtë ankand ishte 0.76% vjetore, gjë që paraqet një dallim prej -40 pikësh bazë krahasuar me normën e interesit të ankandit të kaluar të Obligacioneve 2 vjeçare e cila ishte 1.16%. Njëra ndër arsyet kryesore për këtë rënie të normës është rezultati i referendumit për daljen e Mbretërisë së Bashkuar nga BE. Blerësit sipas kategorive të obligacioneve Qeveritare të Ankandit KV011-16, janë Bankat: 25.94 milionë euro, Fondet Pensionale: 4.06 milionë euro. (Telegrafi, Tribuna Channel, 1 korrik 2016).

KAMATA BIE NË 7.6%



Vlera e kredive aktive, në dhjetë bankat komerciale në Kosovë, në muajin maj ka qenë 2 miliardë e 143 milionë euro. 747 milionë euro është vlera e kredive për ekonomitë familjare dhe 1 miliard e 390 mijë vlera e kredive për ndërmarrjet, shkruan sot Koha Ditore. Sipas BQK-së, ka pasur një rritje vjetore të kredive prej 9.5 për qind, pjesa më e madhe e kësaj rritjeje ka ardhur nga kreditimi i ekonomive familjare që kanë pasur një rritje prej 15.6 për qind. (Telegrafi, Koha.net, 4 korrik 2016).

DIASPORA, 6.3 MILIARDË REMITENCA



Gjatë vitit që lamë pas, dërgesat nga diaspora kanë thyer rekord duke arritur në 752,4 milionë euro apo 58,7 milionë euro më shumë sesa në vitin paraprak. Sipas ekspertëve të ekonomisë, brenda periudhës 2004-2015, remitencat arrijnë në 6.3 miliardë euro. Brenda çdo muaji, dhjetëra miliona euro vijnë nga bashkatdhetarët në diasporë, si dërgesa për familjarët e tyre. Këto mjete që kalojnë shumën mbi 6.3 miliardë euro për 11 vjetët e fundit, shkojnë kryesisht në konsum të përditshëm, duke ndikuar drejtpërdrejt në qetësinë sociale të Kosovës. (Zëri, 4 korrik 2016).

ASETET E SISTEMIT FINANCIAR RRETH 5 MILIARDË EURO



Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës, në mars 2016, arriti në 4.96 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 5.7 përqind. Ndikimin kryesor në zgjerimin e aktivitetit të sistemit financiar në vend e kishin sektori bankar dhe sektori pensional, shkruan Telegrafi. "Sektori bankar në TM1 2016 rriti vlerën e asetëve në 3.40 miliardë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 4.5 përqind (6.5 përqind në TM1 2015). Kontribuesi më i madh në rritjen e asetëve të sektorit bankar ishte zgjerimi i portfolios së kredive që vazhdon të jetë kategoria më e madhe në strukturën e asetëve të sektorit bankar". (Telegrafi, 6 korrik 2016).

AMBIENTI I BIZNESIT NË KOSOVË PO PËRMIRËSOHET



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami ka thënë se ambienti për bizneset po përmirësohet ndërsa Banka Botërore ka publikuar të dhëna që tregojnë se Kosova ka shënuar përmirësim në të

bërit biznes. “Kosova shënon progres substancial në “Indikatorët e Qeverisjes Rregulatore” të matur nga Banka Botërore. Vlerësimi bëhet në bazës te ‘notës’. Vitin e kaluar Kosova është vlerësuar me notën 2.6, ndërsa këtë vit kjo notë është rritur në 4.6 (6 është nota maksimale). Nëse do të përkthejmë rritjen e notës në rangim, mund të konkludohet se Kosova ka pasur një rritje prej afër 30 vendeve në rangim duke u ngritur nga vendi 73 në vendin 43 në botë, nga gjithsej 187 shtete sa janë pjesë e këtij vlerësimi nga Banka Botërore”, ka shkruar Bajrami në profilin e vet në “Facebook”. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, Epoka e Re, 18 korrik 2016).

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVES MIRËPRET NË VIZITË PJESËMARRËSIT E AKADEMISË NDËRKOMBËTARE VERORE (ANV)



Shoqata e Bankave të Kosovës (ShBK) më 12 korrik priti në vizitë pjesëmarrësit e Akademisë Ndërkombëtare Verore. Pjesëmarrësit e kësaj Akademie patën rastin të njoftohen më për së afërmi


me punën dhe misionin e ShBK-së. Ata u njoftuan me stafin, departamentet e ShBK-së, Qendren e Trajnimeve dhe projektet që janë duke u zhvilluar nga Shoqata e Bankave.

Vlenë të përmendet që Shoqata e Bankave të Kosovës ka kontribuar edhe me mbështetje profesionale për Akademinë Ndërkombëtare Verore duke mbajtur ligjeratë për pjesëmarrësit. Ligjerata me temën “Performanca e sektorit bankar” është mbajtur nga drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija. Kjo Akademi organizohet nga Kolegji UBT. (Shoqata e Bankave të Kosovës, 12 korrik 2016).

PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“Periodiku Bankar” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.
www.bankassoc-kos.com.





Qendra për Trajnime Bankare

TRAJNIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2016:

Certifikimi Ndërkombëtar EFCB

Bazat e Pajtueshmërisë

Lidershipi dhe formimi i Ekipeve

Menaxhimi i Riskut Operacional

Menaxhimi i Porfolios së Riskut Kreditor

IFRS

Nga Zyrtar i TI në Auditor të TI

Mbikëqyrja e Stafit

Mirësjellja në Biznes



Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171

kbtraining@bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION